VENDIM
Nr.67, datë 13.9.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË LIDHJES SË RE APO MODIFIKIMIT TË LIDHJES EKZISTUESE NË RRJETIN ELEKTRIK TË OST SHA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të "Rregullave e praktikës dhe procedurave të ERE-s", neni 18, pika 1, germa "c", të miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009, dhe pikës V.3.3, të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.123, datë 24.10.2008, të pikës 3.8.2 të licencës për aktivitetin e transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.35, datë 9.7.2004, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. dhe relacionin përkatës të grupit të punës mbi fillimin e procedurave për miratimin e tarifës së lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a.,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e tarifës së lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a.

2. Ngarkohen drejtoritë teknike të njoftojnë OST-Në për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta